



UNIVERSITETI SHETËTOR I TETOVËS
ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
STATE UNIVERSITY OF TETOVA

UDHËZUES
PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM NË
UNIVERSITETIN SHETËTOR TË TETOVËS

2013/14



DREJT SUKSESEVE
TË REJA



Themelimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës, si njëra ndër ngjarjet më të mëdha historike për shqiptarët e Maqedonisë, ndodhi para 18 vjetëve, më saktë më 17 dhjetor 1994, në një kohë kur shqiptarët e Maqedonisë e ndjenin si kur më parë nevojën për dije dhe arsimit, për të shpëtuar nga kthetrat e errësirës dhe injorancës shekullore, gjithsesi të imponuar nga sundimet e ndryshme, historikisht të njohura për ne. Atëbotë, me nismën e intelektualëve shqiptarë, të disa subjekteve politike, të shoqatave dhe asociacioneve qytetare, të tre kuvendeve komunale: të Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës, shtetit të Maqedonisë iu dha mesazh i qartë, se shqiptarët e Maqedonisë e duan dijen, arsimimin dhe përparimin. Pas 10 vjet pune të palodhshme, plot vështirësi dhe sakrifica, Universiteti i Tetovës, në saje të angazhimit permanent të faktorit politik shqiptar, të dalë nga lufta, u njoh si Universiteti i tretë shtetëror dhe i vetmi universitet shqipfolës deri më sot në Maqedoni. Sot Universiteti Shtetëror i Tetovës ka shënuar të arritura epokale. Ai është ngritur tashmë në një institucion arsimor dhe shkencor me përmasa kombëtare dhe rajonale, duke tërhequr kah vetja profesoratin më të

Fjala e Rektorit

mirë të vendit dhe rajonit, figurat më eminente të arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Universiteti Shtetëror i Tetovës numëron 11 fakultete, 36 programe studimore, 93 drejtime studimore dhe 3 institute kërkimore-shkencore, në të cilët studiojnë mbi 15.500 studentë vendas dhe të huaj. Risia më e këndshme e viteve të fundit janë edhe disperzimet e Universitetit Shtetëror të Tetovës nëpër të gjitha qytetet ku banojnë shqiptarët, si në Shkup, Kumanovë, Kërçovë Dibër dhe Strugë, me çka arsimimi u bë i kapshëm për të gjithë, falë një politike të shëndoshë dhe vizionare, frytet e së cilës kanë filluar të vjelen dhe do të vjelen edhe më shumë në të ardhmen. Sot USHT-ja ndjek një rrugë të shëndoshë të ndërkombëtarizimit, duke qenë lider në nënshkrimin dhe jetësimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me shumë universitete prestigjioze vendore, rajonale dhe evropiane si me: Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi", Universitetin e Tiranës dhe Prishtinës, Zagrebit, Gracit, Manhajmit, Shtutgartit, me Universitetin e Trakisë, Ankarasë, Stambollit, Ulludagut në Republikën e Turqisë, Plovdivit, Veliko Tërnovo (Bullgari), Universitetin e Kalabrisë në Itali, Universitetin Jamk në Finlandë, Universitetin e Anglisë Lindore në Angli, me Universitetin Xhon Majson në SHBA, dhe kështu me radhë. Për herë të parë në historinë e

vet, stafi drejtues i USHT-së ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës për kualifikimin dhe avancimin e asistentëve nëpër të gjitha fakultetet dhe programet studimore në nivelin e doktoraturës, gjë e cila do t'i garantojë shoqërisë tonë një arsimim më cilësor dhe frytdhënës.

Me zyrtarizimin e USHT-së në vitin 2004 ka filluar edhe implementimi i Kartës së Bolonjës në procesin arsimor nëpër të gjitha programet studimore, kryesisht sipas skemës 3+2+3, respektivisht 4+1+3. Deri më tani ka funksionuar niveli deridiplomik Bachelor 3 dhe 4 vjeçar dhe niveli pasdiplomik MASTER 1 respektivisht 2 vjeçar, në përgatitje e sipër janë edhe studimet e Doktoraturës, të cilat synohet të nisin për disa fakultete dhe programe studimore nga viti akademik 2013/2014. Planet dhe programet mësimore vazhdimisht po rishikohen dhe përpunohen, me qëllim të përshtatjes sa më të mirë me Kartën e Bolonjës dhe kërkesave të tregut të punës. Nëpër të gjitha fakultetet dhe programet studimore zhvillohet mësimi interaktiv, duke u mundësuar studentëve pjesëmarrje më të drejtpërdrejtë në lëndët mësimore, me qëllim të transparencës akademike dhe avancimit sa më të madh të gjeneratave të reja.

Plani strategjik i Universitetit dhe stafit drejtues për të ardhmen të tij është krijimi i kushteve sa më të mira të studimit, krijimi i sa më shumë urave të bashkëpunimit me universitetet vendore, rajonale dhe evropiane dhe të SHBA-ve, me qëllim të hapjes së horizonteve të dijes edhe përtej mundësive tona reale, duke pasur parasysh të kaluarën politike dhe historike të vendit tonë.

Në 100 Vjetorin e Flamurit Kombëtar, ne e përruam godinën e re universitare, e cila ofron kushte moderne studimi dhe dëshmon për gatishmërinë dhe përkushtimin e stafit drejtues të Universitetit tonë, për krijimin e kushteve infrastrukturore që janë në përputhje me standardet evropiane.

Ky objekt është vepër kolosale, jo vetëm për Tetovën dhe rrethinën e saj, por për të gjithë studentët nga vendi ynë dhe nga jashtë.

TË NDERUAR MATURANTË,

Më lejoni t'Ju uroj mirëseardhje në Universitetin Shtetëror të Tetovës, dhe përmes këtij Udhëzuesi të informoheni në detaje për mënyrën e aplikimit dhe detyrimet Tuaja. Besojmë se këto informacione do ta lehtësojnë procesin e regjistrimit në Universitetin tonë.

Ju mirëpresim!

**Rektori,
Prof.dr. Vullnet Ameti**

Çka duhet bërë para se të aplikoni?

- Lexo me kujdes konkursin e shpallur për pranimin e studentëve në gazetat ditore dhe në ueb: www.unite.edu.mk;
- Përcaktohu për fakultetin, respektivisht programin studimor që dëshiron të studiosh;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;
- Shih me kujdes ditët kur duhet të aplikosh;
- Lexo me kujdes datat kur shpallen rezultatet dhe kur bëhet regjistrimi.

Ç' është aplikimi?

- Aplikimi është dorëzimi i dokumentacionit të paraparë me konkurs, te referenti i fakultetit që ke vendosur të vijosh studimet.
- Përmes aplikimit fitoni të drejtën e kandidimit të mundshëm për t'u pranuar, pasi që konkurren me të gjithë kandidatët tjerë që kanë aplikuar në të njëjtin program studimor.

Si bëhet aplikimi:

- Plotëso fletëparaqitjen për aplikim me të dhënat tuaja;
(fletëparaqitja merret në hapësirat e fakultetit ku dëshiron të aplikosh)
- Në formular thekso saktë emrin e Fakultetit dhe Programit studimor;
- Rretho statusin e studimeve: i/e rregullt apo me korrespondencë.
- Bëje pagesën e caktuar për aplikim, fletëpagesën e ngjitur në formularin për aplikim;
- Kompletu dokumentacionin:
 - Çertifikatë nënshtetësie
 - Çertifikatë të lindjes
 - dëftesat për kryerjen e shkollimit të mesëm
 - Diplomën për kryerjen e shkollimit të mesëm
 - Vërtetim që dëshmon se kandidati është i punësuar (për atë që dëshiron të studiojë me korrespondencë).

Çka ndodhë nëse nuk e bën aplikimin në rregull:

Komisioni për pranim të studentëve mund t'ju:

- rangojë gabimisht;
- ndërrojë programin studimor që ke aplikuar;
- ndërrojë statusin e studimeve;
- vendos në kuotë që nuk ke dëshiruar ;
- të mos shpallet aspak emri në listë për pranimin e studentëve;

Pas aplikimit?

Komisioni që shqyrton dosjet detyrimisht në datën e caktuar me konkurs shpallë rezultatet preliminare për pranimin e studentëve. Rezultatet shpallen në hapësirat e fakultetit ku është bërë aplikimi si dhe në ueb faqen e universitetit: www.unite.edu.mk.

VINI RE: Rezultatet preliminare nuk janë definitive, por janë rezultate ku ende ka hapësirë të korrigjohet ndonjë lëshim i mundshëm nga ana e Komisionit për pranim.

Arsyet për mospranimin e kandidatit:

- Pikët e arritura në bazë të suksesit nga shkollimi i mesëm;
- Plotësimi i vendeve të lira me kandidatë me sukses më të mirë ;
- Mungesa e pikëve që arrin kandidati në provim pranues (te ato programe studimore ku pranimi bëhet në bazë të provimit pranues) është më i ulët se 10 pikë, apo në konkurrencë me të tjerët më të ulëta;
- Nëse nuk ke dhënë maturën shtetërore, ke vetëm 20 pikë më pak se ata që janë me maturë shtetërore si dhe ata që kanë diplomuar para vitit 2007. Këto dy kategori kanë përparësi në rangim pavarësisht nga pikët që i arrijnë në konkurrencë me ata që kanë vetëm maturën shkollore;
- Nëse ke diplomuar jashtë R. Maqedonisë, por je shtetas i RM-së, mirëpo nuk posedon vendim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së R. Maqedonisë për pranimin e shkollimit të mesëm;
- Nëse shkollimi i mesëm është trevjeçar;
- Nëse lëndët interne nuk janë kompatible me programin e lëndëve që janë paraparë në atë program studimor, atëherë përparësi kanë kandidatët që kanë lëndët e duhura interne.

Komisioni nëse ka gabuar në rangim atëherë;

- Në afat prej 24 orësh nga momenti kur shpallen rezultatet preliminare duhet, të dorëzosh një ankesë në Arkivin e USHT-së drejtuar Komisionit Qendror të Universitetit;
- Në ankesë të precizohet saktë çka dëshiron;
- Komisioni Qendror i shqyrton ankesat dhe sjell vendimin përkatës;

Pse parashtrohet ankesa?

Ankesa parashtrohet për evitimin e lëshimit të mundshëm që mendon se është bërë rreth rangimit tënd.

Përmes ankesës e informon Komisionin Qendror për këto lëshime:

- Nëse emri nuk është i shpallur në listë (emri duhet detyrimisht të jetë i publikuar pavarësisht rezultatit të arritur);
- Nëse pikët e suksesit janë llogaritur gabimisht;
- Nëse Komisioni gabimisht të ka ranguar në ndonjë program tjetër studimor;
- Nëse nuk e ke të qartë arsyen e mospranimit etj.

Pranimi i përgjigjes në ankesën e kandidatit?

Përgjigjen e ankesës kandidati e pranon në formë të shkruar me një vendim që Komisioni Qendror e sjell në bazë të ankesës. Këtë vendim e pranon në Arkivin e USHT-së. Përgjegjësinë për mospranimin e vendimit në kohën e duhur, e bartë vetë kandidati.

Si realizohet rangimi i kandidatit ?

- Radhitja e kandidatit në listë bëhet në bazë të pikëve të fituara;
- Kandidati që ka aplikuar për status të rregullt të studimeve por që ka pikë më të larta, ai hynë në kuotën shtetërore për atë vend të lira sa parashihet në konkurs;
- Kandidatët tjerë hyjnë me vetëfinancim atë sa ka vende të lira me konkurs për këtë kuotë;
- Pasi të plotësohen të gjitha vendet e lira, kandidatët tjerë mbeten të papranuar;
- Kandidatët që aplikojnë me korrespondencë nuk konkurrojnë në këto dy kuota, por ata konkurrojnë me kandidatët që aplikojnë me status të studimeve me korrespondencë. Për këtë kategori të kandidatëve vlejnë rregullat që u theksuan më lartë.
- Pasi të plotësohet numri i kandidatëve me korrespondencë, të tjerët mbeten të papranuar, pavarësisht se mund të ketë vende të lira në kuotë shtetërore apo vetëfinancim.

Kandidatët që nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë?

- Shtetasit jovendorë gjatë rangimit nuk konkurrojnë me shtetasit e RM-së;
- Për këto kandidatë është paraparë numër i kufizuar për tu pranuar, që nuk tejkalon 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve në nivel të fakultetit.
- Pasi të plotësohet ky numër në nivel të fakultetit, kandidatët tjerë nuk pranohen;

Rezultatet përfundimtare

Pas shqyrtimit të ankesave, Komisioni Qendror shpall rezultatet përfundimtare në hapësirat e fakulteteve përkatëse, si dhe në ueb faqen e universitetit: www.unite.edu.mk. Rezultatet përfundimtare janë definitive dhe shpallen me aktvendim të plotfuqishëm nga Komisioni Qendror pa të drejtë ankese.

Si realizohet regjistrimi ?

Kandidati i pranuar, drejtohet në fakultetin përkatës për realizimin e regjistrimit sipas kësaj procedure:

- Paraqitja te referenti i fakultetit;
- Fletëparaqitja për regjistrim;
- Tre fotografi;
- Bën pagesën e semestrit të parë në shumën që është paraparë për kuotën që je pranuar;

• Bën pagesat tjera për:

- Shumat që duhet të paguani i lexoni në konkurs
- Index
- Parlamentin Studentor

Shumat që duhet të paguani i lexoni në konkurs

- Veprimtaritë informative, kulturore të studentëve të Universitetit
- Regjistrimi përfundon vetëm nëse fletëparaqitjen, fotografitë dhe fletëpagesat për pagesat e kryera i dorëzon te referenti i fakultetit, ndryshe regjistrimi juaj nuk ka përfunduar, respektivisht konsiderohesh i paregjistruar.

KUJDES! çka ndodh nëse je pranuar por nuk ke bërë regjistrim në afatin e caktuar?

Nëse në afatin e paraparë për regjistrim sipas konkursit nuk e ke bërë regjistrimin atëherë:

- Konsiderohet se ke hequr dorë nga studimet në Universitet edhe pse je pranuar;
- Vendi i plotësuar në cilëndo kuotë, në konkursin e ardhshëm për pranim të studentëve shpallet si vend i lirë;
- Në afat sa më të shkurtër dokumentacioni i dorëzuar të tërhiqet, në të kundërtën Universiteti nuk bart përgjegjësi;

Nëse nuk regjistrohesh në kohën e paraparë ?

- Ke të drejtë të aplikosh përsëri sipas procedurave të njëjta;
- Aplikon vetëm në ato programe studimore ku kanë mbetur vende të lira;
- Nuk ruhet statusi i kuotës që ke pasur në afatin paraprak;

Zyra për arsim
Universiteti Shtetëror i Tetovës



FAKULTETET

JURIDIK

EKONOMIK

FILOLOGJIK

FILOZOFIK

ARTET

KULTURË FIZIKE

ADMINISTRATË E BIZNESIT

SHKENCAT E ZBATUARA

SHKENCAT E MJEKËSISË

SHKENCAT MATEMATIKO-NATYRORE

TEKNOLOGJIA USHQIMORE DHE TË USHQYERIT



AFATET



AFATI I PARË

19 gusht - 23 gusht - Aplikimi

27 gusht - 30 gusht - Regjistrimi

AFATI I DYTË

03 shtator - 06 shtator - Aplikimi

09 shtator - 13 shtator - Regjistrimi





Рruga e Ilindenit рn, 1200 Tetovë, Republika e Maqedonisë
Tel: +389 44 356 500
Fax: +389 44 334 222
e-mail: info@unite.edu.mk